

FEMART



EDICIONI 1 2013



EDICIONI 2 2014



EDICIONI 3 2015



NDËRVITE

EDICIONI 4 2016



EDICIONI 5 2017



EDICIONI 6 2018



EDICIONI 7 2019





NDËRVITE

EDICIONI 1

27-30 Maj 2013

EDICIONI 2

27-31 Maj 2014

EDICIONI 3

7-12 Tetor 2015

EDICIONI 4

25-30 Maj 2016

EDICIONI 5

25-31 Maj 2017

EDICIONI 6

25-30 Maj 2018

EDITION 7

10-16 Qershor 2019



FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I ARTISTEVE DHE AKTIVISTEVE

Filloi si një ambicje dhe dëshirë e madhe, për të vazhduar më tutje si një domosdoshmëri për shoqërinë e vendit dhe të rajonit dhe vijoi duke u shtri edhe më gjërë vetëm e vetëm për të plasuar art, solidaritet, humanizëm, paqë, liri, argëtim, gëzim, empati, fuqizim. Nisur nga vështirësitë me të cilat ballafaqohen gratë dhe grupet e marginalizuara në Kosovë dhe rajon në baza të përditshme, ngritja nga këto vështirësi duke u përballur dhe duke i përmbysur normat sociale që i mbajnë ndër breza, **Qendra për Art dhe Komunitet – Artpolis** për shtatë vjet radhazi, që nga viti 2013, organizon festivalin që synim e ka luftimin e këtyre vështirësive. Kjo nismë e bukur e artit u bë skenë për tu dëgjuar zërat e artisteve dhe aktivisteve dhe qysh në edicionin e parë mori formën e një festivali prestigjioz.

Festivali vazhdon të jetë një platformë për inicimin dhe prezantimin e ideve dhe krijimeve që sjellin përpara konceptet e feminizmit dhe zhvillimet e tyre në Kosovë si dhe avokimin e të drejtave të barabarta dhe ndërtimin e paqës në rajon.

FemArt mbledhi së bashku artistë vendorë, rajonal dhe ndërkombëtar të të gjitha llojeve të ekspertizës, nga ekspozuesit për herë të parë e deri te profesionistët me përvojë. Të përfshirë kanë qenë gra artiste dhe aktiviste, por edhe burra me qëndrime feministe, që krijojnë filma, shfaqje teatrore, fotografi, muzikë, krijime letrare por edhe krijues/e dhe profesionist/e të tjerë/a që kontribuojnë me hulumtime, diskutime e shkëmbime të informatave.

Programi i larmishëm i festivalit FemArt jo vetëm që është edukativ, por edhe argëtues, i cili ka arritur ta përfitojë një publik të gjërë divers e ta lëjë me një eksperiencë të kompletuar. Këto programe të edicioneve të festivalit u zgjodhën nga një grup artistësh dhe aktivistësh të shoqërisë civile, të cilët kanë përvojë në forma të ndryshme të artit dhe që kanë një lidhje midis çështjeve sociale dhe krijimeve të artit.

Motot e festivalit ndër vite, si “Ne nuk jemi ishull”, “E patrembur”, “Ti udhëheq”, “Me Liri Kundër Marrës”, etj. ishin inspirim dhe orientim i artisteve dhe aktivisteve për të shfaqur krijimet e tyre dhe për të ngritur apo luftuar çështjet që ishin aktuale për atë vit të edicionit. Të frymëzuar/a nga temat shoqërore dhe të drejtat e njeriut në Ballkan e më gjerë, ata/o u bashkuan në këtë platformë dinamike të festivalit dhe në mënyrë artistike e informuan publikun për problemet shoqërore me të cilat ballafaqohen gratë e Kosovës dhe rajonit.

“Gjatë gjithë kësaj jave Prishtina ka fituar më shumë ndjesi femërore falë performancave, muzikës dhe panelisteve që FemArt ka mbledhur nga e gjithë bota. Duke përdorur artin, shkrimet dhe performancat teatrore kemi bërë një hap në luftën për të drejta dhe barazi gjinore. Duke na çuar në një turne rreth Prishtinës, herë në Galerinë Kombëtare, herë në Teatrin Oda e herë në ambientet e Hotel Grand, FemArt ka provuar ta kthejë vëmendjen te temat që kanë tendencë të lihen anash apo të diskutohen vetëm gjatë Ditës Ndërkombëtare të Grave.” – shkruan KultPlus në njërin nga artikujt e shumtë për FemArt.

“Unë do doja që FemArt të zgjaste 365 ditë në vit sepse është vërtetë një festë e Artit, një “ekspozitë” e mrekullueshme me vlera të vërteta.” – shprehet aktorja nga Shqipëria Egla Ceno.

“Jam shumë e lumtur që kam marrë pjesë në një përvojë të rëndësishme si FemArt. Në veçanti, unë vlerësova programin që keni zhvilluar, i cili mbledhi mysafirë ndërkombëtarë dhe çështje specifike që lidhen me Kosovën në debat. Personalisht jam shumë i lumtur me organizimin, jam mirëpritur që nga arritja ime dhe u shoqërova në mënyrën më të mirë gjatë qëndrimit tim. Kështu që ju falënderoj të gjithëve për përvojën e shkëlqyeshme.” – artistja nga Italia Silvia Basso.



FEMART FESTIVAL 1


27-30 maj 2013

Festivali i parë rajonal feminist në Kosovë u organizua për 4 ditë, filloi si një festival i vogël por ka arritur misionin e tij duke u bërë një vend mikpritës për gratë artiste për të treguar artin e tyre, të frymëzuara nga temat sociale dhe dëshira për respektimin e të drejtave të tyre, për të siguruar një atmosferë argëtuese dhe dinamike që vizitorët të mësojnë mbi çështjet sociale me të cilat përballen gratë e Kosovës dhe gratë artiste në rajon.

Motoja e vitit 2013 ishte **“Ne nuk jemi ishull”**, duke synuar të forcojmë diskutimet dhe të tërheqim vëmendje për çështjet që lidhen me feminizmin në Kosovë dhe të shërbejë si një thirrje për më shumë bashkëpunime ndërmjet grave kosovare dhe atyre nga rajoni si aktore të rëndësishme në ndërtimin e paqes dhe rritjes së bashkëpunimit.

Teatri Oda në Prishtinë, ishte nikoqir i edicionit të parë të festivalit FemArt.

Gjatë katër ditëve të festivalit ishin mbi 60 artistë/e dhe aktivistë/e (gra dhe burra) nga vende të ndryshme që u përfaqisuan përmes aktiviteteve dhe projekteve të tyre si dhe vullnetarëve/eve të rinj / reja të komuniteteve që jetojnë në Kosovë.



Kosova



Bosnja dhe
Hercegovina



Maqedonia
Veriore



Serbia



Shqipëria



Suedia

Festivalin e vizituan rreth: **2000** njerëz.

Edicioni i I-rë i festivalit FemArt u përkrah nga donatorët: Kvinna till Kvinna, Projekti i fondeve të BE menaxhuar nga zyra e Bashkësisë Evropiane në Kosovë, UNDP.

Sponsorë medial: TV21, KOHA.





Ekspozita fotografish



Shfaqje teatrale



Filma të shkurtër,
dokumentarë
dhe diskutime



Koncerte



Natë poezie



Promovim
libri dhe
diskutim



Ndeja

DITA 1



Performancë muzikore me koreografi, me solistët: Kaltrina Miftari & Safet Morina, balerina Teuta Krasniqi & piano Melos Buza.

Eskpozitë fotografish "Në ndërkohë" nga Majlinda Hoxha.

Ndejë koktej



Panel diskutimi: "Gratë në Luftë".

Prezantim special i filmave të shkurtër të regjisoreve kosovare: "Kthimi" nga Blerta Zeqiraj, "Ninullë" nga Antoneta Kastrati, "Shkurta" nga Arzana Kraja dhe "Kofja e zbrazët" nga Antoneta Kastrati.

Prezantim dhe diskutim "Ekspozita Bogijevci" nga Saranda dhe Jehona Bogujevci.

Prezantim i filmit dokumentar "Lufta e Grave" nga Marika Griehsel / Suedi.

Performancë teatrale "Kalimi i vijës" nga Dijana Milosević nga DAH Theatre/ Serbi.

Lexime poetike "Poezi dhe Dashni" me interpretueset Anisa Ismajli, Melihate Qena, Bislim Muçaj & Shengyl Ismajli.

Performancë muzikore me këngëtareshen Egzona Ademi dhe kitarë Florin Fanaj.



DITA 2



DITA 3



Diskutim: "Filma dokumentarë nga rajoni – Në rrugën drejt BE-së"

Prezantim i filmave: "Nuk jemi në parajsë" nga Lendita Zeqiraj Kosovë/Francë, **"Qyteti i pa/dukshëm"** nga Nataša Poplavska / Maqedonia Veriore, **"Tingulli i parë i vërtetë i grave"** nga Brankica Drasković / Serbi.

Prezantim i filmit dokumentar, intervistë me Simone de Beauvoir rreth **"Pse jam feministe"**.

Prezantim dhe diskutim për BEFEM FESTIVAL dhe skenën feministe në Serbi me Christina Wassholm dhe Jelena Visnjić.

Ekspozitë fotografish e feministeve "CURE" nga Bosnia dhe Hercegovina.

Performancë teatrale "Seks?! Faleminderit, sa për ta provuar" nga Merita Smaja / Shqipëri.



Prezantim i filmit me diskutim: "Portretet e Lirisë" nga Kaltrina Krasniqi, **"Pasqyrë, pasqyrë"** nga Blerta Basholli, **"Harmonika"** nga Burbuqe Berisha dhe **"Lindja nuk pyet"** nga Parta Kelmendi.

Promovim i librit dhe panel diskutimi: "Qenia nuk banon këtu" nga Sibel Halimi me panelistet: Nerimane Kamberi, Halil Matoshi & Lulzim Haziri.

Performancë teatrale "Pastrimi i idiotit" nga Aleksandra Kovacević / Teatri i Kraljevës / Serbi

Ndejë koktej.

Koncert i korit të grave "VOX ART" me Ylber Asllanaj – dirigjent dhe Rina Bilurdagu – Piano.



DITA 4





FEMART FESTIVAL 2

27-31 maj 2014


Edicioni i dytë i festivalit Femart u organizua në institucionin më të lartë kulturor në Kosovë - përkatësisht në **Teatrin Kombëtar të Kosovës** gjatë 27-31 maj, 2014.

Edicioni i këtij viti ishte shumë i veçantë për faktin se janë financuar produksione premierë si: (shfaqje, ekspozita, promovime librash dhe botime) të artistëve të rinj dhe të talentuar të Kosovës dhe rajonalë me temat e seksualitetit, ballafaqimit me të kaluarën, dhuna kundër grave si dhe për Komunitetin LGBTQI.

Programi i festivalit Femart ka përfshirë por duke mos u kufizuar me tema si: Të drejtat e njeriut, shëndeti riprodhues dhe seksualiteti, dhuna në baza gjinore, drejtësia tranzicionale në Ballkan, fuqizimi i grave, dhuna seksuale gjatë luftës, bashkëpunimi rajonal etj.

Festivali gjithashtu u bë pjesë e nismës kombëtare për fondin e Solidaritetit për përmbytjet në rajon (Serbi, BeH dhe Kroaci) duke shitur çanta dhe bluza me logon e festivalit dhe duke mbledhur të gjitha fondet për fondin e solidaritetit.

Gjatë pesë ditëve të festivalit, ishin mbi 150 artistë dhe aktivistë (gra dhe burra) nga vende të ndryshme që u përfshinë përmes aktiviteteve dhe projekteve të tyre. Vullnetarët /et nga komunitetet që jetojnë në Kosovë ishin pjesë e festivalit gjithashtu.



Kosova



Franca



Kanada



Mali i Zi



Maqedonia
Veriore



Serbia



Shqipëria

Në festival morën pjesë: **2,000** njerëz.

Edicioni i II-të i festivalit FemArt u përkrah nga donatorët: Kvinna till Kvinna, Ars Progeti me fondet të Bashkësisë Evropiane, UNFPA, AGGA, Komuna e Prishtinës, RRGK.

Sponsorë medial: TV21, Koha





Performancë - premierë



Lexime në skenë
premierë



Punëtori

Ekspozita



Shfaqje teatrale

Koncerte




Promovim
libri



Filma të shkurtër




Filma dokumentarë



Lansimi i Uebfaqes, prezantime
dhe diskutime mbi aktivizmin dhe
artin në rajoni.



Lansimi i webfaqes



Natë poezie

Ndeja



DITA 1



Hapja e festivalit

Performancë teatrale "Trëndafilin n'Elbasan" – premierë nga Arta Gashi dhe Fikrete Miftari.

Prezantim "Në kujtim të Nënës" - premierë nga Besa Neziri Rugova – Dizajnere e modës dhe Saranda Bogujevci – Kuratore, Kosovë/Britani e Madhe/SHBA.

Ekspozitë "Kështu nuk vritet një grua" nga Suzana Varvarica Kuka and artists: Suzana Varvarica Kuka, Greta Dhaskali Lami / Shqipëri, Marta Zadrima / Mali i Zi dhe Gai le Japoni /Kanadë.

Koktej dhe ndejë me muzikë nga Oda Haliti.



Punëtori për punimin e bizhuterive "Eksploro – Ëndërro – Zbulo" nga Nataša Ljubinković / Serbi.

Promovim i librit dhe panel diskutimi: "Momentet" - autore Anisa Ismajli, paneliste Ilire Zajmi Rugova. Interpretojnë: Shengyl Ismajli, Armend Ismajli, Dardana Mehmeti dhe Fitore Broqi.

Performancë teatrale:

"COMME MOI, LE PLAF" (Si unë, Piaf) / Maqedonia Veriore, Regjia: Nataša Poplavska, aktorja Elena Moshe, muzika FOLTIN, Producent Art Media dhe National Theatre Bitola.

Ndeja dhe muzikë me Aoude Le Pape / Francë.



DITA 2

DITA 3



Punëtori për punimin e bizhuterive "Eksploro – Ëndërro – Zbulo" nga Nataša Ljubinković / Serbi.

Punëtori: "Teatri shërues/Shërimi i Teatrit" nga Nataša Poplavska / Maqedonia Veriore.

Prezantim special i filmave të shkurtër të regjisorëve kosovare:

"Balcony" nga Lendita Zeqiraj, **"Rrobaqepësja"** nga Arlinda Morina, **"Amel"** nga More Raça, **"Ajo vjen në Pranverë"** nga Antoneta Kastrati dhe **"Ne të tre"** nga Blerta Basholli.

Performancë teatrale: "Nënat dhe bijat" nga regjisorja Rozi Kostani, Drejtoreshë artistike Suela Konjari, autor Aleksander Mardan, aktoret: Valina Muçolli dhe Egzona Ademi, Prodhuar nga Teatri i Metropolit / Shqipëri.

Ndejë dhe muzikë me Agnes Nokshiqi.

DITA 4



Punëtori: "Teatri shërues/Shërimi i Teatrit" nga Nataša Poplavska / Maqedonia Veriore.

Përtej historisë: Lansimi i Webfaqes të Iniciativës Kosovare për Historinë Gojore; Prezantimi i pesë filmave të shkurtë, nga Igballe Rogova /RRGK dhe Dr. Anna Di Lellio/ The New School US; **Diskutim:** Dr. Anna Di Lellio, Kaltrina Krasniqi – Regjisore dhe Nicole Fransworth / RRGK.

Prezantim i filmave dokumentarë: Balkan Femmes Docs **"SEX"** nga Kaltrina Krasniqi / Kosovë, **"SkaNdal"** nga Elton Baxhaku & Erjona Cami / Shqipëri, **"Stigma"** nga Blerta Zeqiri / Kosvoë dhe **"Kockat e forta"** nga Gordana Simonović Veljeković / Serbi

Lexim skenik – premierë, autore dhe regjisore Arjeta Ajeti **"Ëndërr Amerikane apo Ankth Ballkanas"** me aktorët/et: Arjeta Ajeti, Arben Kastrati, Rebeka Qena, Lulzim Bucolli, Arbnesha Grabovci Nixha, Fiona Gllavica, Florist Bajgora dhe Alban Zogaj.

Ndejë dhe muzikë me Lura Elezi / Shqipëri.

Prezantime dhe diskutime "Aktivizmi dhe Arti në Rajon" me aktivistet nga Kosova, Serbia, Shqipëria dhe Bosnia e Herzegovina: CURE, AKT WOMEN, IMPULS, Dera e Hapur, Centar Za Pravnu Pomoc Ženama, Eliza Hoxha, RRGK.

Ekspozitë & koncert "Kufijtë" nga Ana Čurčin – Act Women / Serbi

"Poezi feministe" selektuar nga Shpetim Selmani dhe Interpretueset: Safete Rogova, Melihate Qena dhe Vlora Nikqi.

Prezantim i filmit dokumentar "Ekskluzive:Krimi i padënuar që flet" - nga Valdete Osmani / Shqipëri dhe këngës **"Heshtja e këngës"** nga Eliza Hoxha / Kosovë

Lexim skenik "Monologët e vaginës" autore Eve Ensler, Regjia: Burbuqe Berisha.

Koktej rasti dhe muzikë me Oda Haliti.

Ndejë me performancë muzikore nga Edona Vatoci – Piano, Vokal dhe Kitarë.



DITA 5



FEMART FESTIVAL 3


07-12 tetor 2015

Edicioni i tretë i festivalit FemArt u mbajt nga 7 deri më 12 tetor, 2015, në Prishtinë dhe nikoqirë të aktiviteteve ishin: Teatri Oda, Fakulteti i Arteve, Teatri Dodona, Teatri Kombëtar i Kosovës dhe EUICC.

FemArt si i vetmi festival feminist në Kosovë dhe më i madhi në rajon gjatë gjashtë ditëve shfaqti performanca teatrore, përballje poetike, ekspozita, punëtori, koncerte e shumë aktivitete tjera me fokus në temat rreth dhunës seksuale në konflikt, dhunës në përgjithësi, të drejtat dhe shëndeti riprodhues i grave, feminizmi në vend dhe rajon e të tjera çështje që janë tema tabu në Kosovë.

Shumica e këtyre aktiviteteve ishin premierë në Kosovë dhe të gjitha kanë qenë pa pagesë për publikun.

Gjatë gjashtë ditëve të festivalit, ishin mbi 70 artistë/e dhe aktivistë/e (gra dhe burra) nga vende të ndryshme që u përfshinë përmes aktiviteteve dhe projekteve të tyre. Vullnetarët/et që ishin të rinjtë dhe të rejtat e komuniteteve të Kosovës e pasuruan edhe më shumë festivalin.



Kosova



Austria



Bosna e
Hercegovina



Britania e
Madhe



Danimarka



Gjeorgjia



Gjermania



Italia



Maqedonia
Veriore



Serbia



SHBA



Shqipëria



Zvicra

Festivalin e vizituan mbi **3000** njerëz.

Donatorët & Përkrahësit: Kvinna till Kvinna, Ambasada Suedeze, Ambasada Holandeze, Ministria e Kultures, Rinisë dhe Sportit, Ambasada e Amerikës në Kosovë, Komuna e Prishtinës, UNFPA, Ministria e Integritetit Evropian, RRGK, Hotel Emerald, UN Women, KTV, RTK, Klan Kosova, Tribuna Channel, RrokumHD, Kultplus,

Partnerët institucional: Universiteti i Prishtinës, Teatri Oda, Teatri Dodona, EUICC.





Video prezantim



Performanca teatore




Ekspozita



Ndeja



Punëtori



Filma dokumentar



Panele diskutimi



Koncerte



Lexime skenike



Performancë Poezi dhe Muzikë

DITA 1



Hapja - Video prezantim i konceptit të festivalit FemArt.

Performancë teatrore: “Krisjet janë ashtu siq hyn drita”
nga Deirdre Morris – SHBA – premierë.

Përballje Poezish “Gypsee Yo” nga Jonida Beqo,
nga Shqipëria

Ekspozitë -Premierë në Kosovë “Qenia proteine, bota sterile”
nga Salome Kokoladze, Gjeorgji/Hungari.

Koktej rasti dhe ndejë me performancë nga Ivana Dragsiqi
nga Maqedonia Veriore.



Punëtori: “Teatri fizik” me Deirdre Morris dhe Kathryn Mark nga SHBA.

Takim me shkrimtaren: Flutura Açka nga Shqipëria, moderuar nga
Naime Beqiraj.

Film dokumentar “Misioni dhunimi – Një mjet dhune” nga
Annette Mari Olsen, Katia Forbert – Petersen Danimarkë/Bosnie e
Hercegovinë/Britani e Madhe.

Panel diskutimi “Dhuna seksuale në konflikt” me panelistet: Igballe
Rogova, Flora Macula, Jeta Krasniqi dhe Feride Rushiti, moderuar nga Zana Hoxha.

Ekspozitë dhe koncert “Muzë” - premierë, nga Mjellma dhe Flaka Goranci, Kosovë /
Austria.

Performancë teatrore “Dridhja e trëndafilut” – premierë, nga Dijana Milosević dhe
Maja Mitić nga DAH Teatar, Serbi

Ndejë.



DITA 2



DITA 3



Punëtori: “Teatri fizik” me Deirdre Morris dhe Kathryn Mark nga SHBA.

Punëtori Teatri me Dijana Milosević dhe Maja Mitić nga DAH Teatar, Serbi

Punëtori “Integrated Security” nga Yllka Soba.

Panel diskutimi: “Feminizmi online cili është impakti?” me panelistet:
Elonë Kastrati, Shqipe Gjocaj, Rreze Abdullahu dhe Donjeta Morina,
moderatorë: Lura Limani.

Prezantimi i filmave të shkurtër dokumentar: “Smaji” - Zymryte Hoxhaj
dhe Philipp Majer / Gjermani,, **“Ku është Doni?”** - More Raça / Kosovë dhe
“Brenda ka dritë” - Rea Surroi dhe Dardan Selimaj / Kosovë.

Performancë teatrore: “Vajza me Diell në kokë” – premierë,
me Agnes Nokshiqin dhe Donikë Ahmetin.

Lexim skenik - premierë “Dashnorët e Pikasos” nga
Arbnesha Grabovci – Nixha.

Ndejë dhe koncert nga FemArt Band – Nita Bahtiri, Njomzë Bislimi,
Rabije Krasniqi dhe Xheneta Durguti.

DITA 4



Punëtori: “Fuqizoje atë” nga Sara Saljić, Serbi/BeH.

Panel diskutimi “Feminizmi model” me panelistet: Sevdije Ahmeti dhe Ljerka Čurčin, Kosovë/Serbi, moderatore: Sibel Halimi.

Prezantimi i filmave të shkurtër dokumentar: “Arkitektura e mër-zisë”- premierë në Kosovë, nga Ermela Teli / Shqipëri, dhe “**Kangë dhe Defa**” nga Fatime Kosumi.

Ekspozitë “Unë jam”- premierë, artistet: Arlinda Hajrullahu, Blerta Surroi, Burbuqe Berisha, Eliza Hoxha dhe Mjellma Goranci.

Poezi dhe muzikë – premierë në Kosovë, nga Elina Duni dhe Besa Myftiu - Zvicër/Shqipëri.

Ndejë.

Punëtori shkrimi “Shprehe. Mos e mbaj.” nga Lura Elezi / Shqipëri

Panel diskutimi: “Dita botërore e fëmijës vajzë” me panelistet: Visare Mujko Nimani, Linda Gusia e Merita Limani.

Performancë “BabyAlarm” – premierë, me Erëmira Çitaku – Flautë, vokal dhe efekte elektronike.

Performancë teatrale “Dada – Një ese në lëvizje me Gazetaren” – premiere, nga Sanije Krsmanović Tasić, Hleb Theatre dhe Bitef, Serbi.

Dy ekspozita premierë “Doja të pikturoja” nga Jana Jakimovska / Maqedonia Veriore dhe “**Fragjile**” nga Shqipe Mehmeti / Maqedonia Veriore

Performancë teatrale “Shtatë pamje” – premierë në Kosovë, nga Tanja Miletić Orudević, nga Mostar Youth Theatre / BeH.

Ndejë.

DITA 5



DITA 6



Punëtori shkrimi “Shprehe. Mos e mbaj.” nga Lura Elezi / Shqipëri

Panel diskutimi “Trupim im, Territori im” me panelistet: Ivana Smailjanić / Serbi and Valbona Xibri / Itali , moderatore: Besa Luci.

Punëtori “Arti dhe LGBT” nga Xheni Karaj / Shqipëri

Performancë teatrale: “Lufta në kohën e dashurisë” nga Blerta Neziraj.

Ndeja me Vala Mulliqi, Fatjon Myftaraj dhe Art Lokaj.



FEMART FESTIVAL 4


25-30 maj 2016

Edicioni i katërt i festivalit FemArt i cili u mbajt në datat 25 deri 30 maj, në Prishtinë, ofroi një javë të tërë me aktivitete të cilat u mbajtën në: Teatri Oda, Fakulteti i Arteve, Biblioteka Kombëtare dhe Teatri Kombëtar i Kosovës.

Programi i festivalit përfshinte tema të ndryshme, si: dhuna ndaj grave, dhuna seksuale gjatë luftës, të drejtat e njeriut, paqja dhe drejtësia tranzicionale në Ballkan, fuqizimi i grave, të drejtat LGBTQI, të drejtat e shëndetit seksual dhe riprodhues, aktivizmi me fokus të veçantë tek të rinjtë, shkëmbimi i përvojave të suksesshme në rajon dhe në botë. E gjithë puna e paraqitur adresoi çështje që kanë të bëjnë me mirëqenien sociale dhe të drejtat e njeriut.

Gjatë gjashtë ditëve që zgjati festivali, i gjithë programi ishte i qasshëm për të gjithë grupet e komunitetit dhe ishte falas për të gjithë publikun.

Gjatë gjashtë ditëve të festivalit, mbi 100 artistë/e dhe aktivistë/e (gra dhe burra) nga vende të ndryshme ishin të përfshirë përmes aktiviteteve dhe projekteve të tyre, e poashtu edhe vullnëtarët/et që ishin pjesë e komuniteteve që jetojnë në Kosovë.



Kosova



Austria



Belgjika



Gjermania



Iraku



Islanda



Jordania



Kanada



Maqedonia
Veriore



Meksika



Serbia



Shqipëria



The Reunion
Island

Festivali u vizitua nga: **4,000** njerëz.

Donatorët & Përkrahësit: Kvinna till Kvinna, Ambasada Suedeze, Culture for All – Zyra e Bashkësisë Evropiane në Kosovë- Implementuar nga: Inter Art, Komuna e Prishtinës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Zyra e Kryeministrit/Agjencia për Barazi Gjinore, UNFPA, RRGK, FIQ, Ambasada Austriake, Ministria e Integritetit Evropiane, mama bar berlin.

Sponsorët medial: KTV, Kosovo 2.0, Klan Kosova, RTK, TV21, RrokumHD, Kosovalive Express, Kultplus.

Partnerët institucional: Universiteti i Prishtinës, Teatri Kombëtar i Kosovës, Teatri ODA, EUICC, Biblioteka Kombëtare, DAM Festival.



Prezantim




Performancë teatrore




Film



Ekspozita



Ndejë



Promovim i librit

Punëtori



Filma të shkurtë dhe dokumentar



Koncerte

Panele diskutimi



Ligjeratë dhe diskutim publik



Pop In bisedë



Master Klasë



Përbalje poetike

Muzikë dhe balet

DITA 1



Hapja e festivalit me një humor të lehtë dhe qasje ironike ndaj pozitës së gruas në shoqërinë kosovare.

Prezantimi i filmit “Bota” – premierë, regjisore Iris Elezit/ Prishtinë.

Ekspozitë dhe performancë “Revolta kundër Dhunës”, artistja Fitore Berisha / Islandë, e përcjellur me performancë me Agnes Nokshiqi dhe Tristan Halili.

Koktej rasti dhe muzikë me Hana Zeqaj.

Master klasë “Diversiteti kulturor nga perspektiva e gruas” dhe kontributi i grave në kulturë, nga Brigitte Kaquet nga Belgjika

Panel diskutimi “Regjia dhe Mizogjinia”, me panelistet: Blerta Zeqiri, Kaltrina Krasniqi, Lendita Zeqiraj, More Raça, Arlinda Morina dhe moderatore Zana Hoxha Krasniqi.

Prezantimi i filmit dokumentar “Motrat Qirazi” dhe panel diskutimi **“Modelet e feminizmit”,** me panelistet: Lepa Mladenović nga Serbia dhe Igballë Rugova nga Kosova dhe moderatorin: Ariana Qosaj Mustafa.

Performancë teatrore: “Copë Copë”, Dramaturge: Blerta Zeqiraj; Regjisore: Zana Hoxha Krasniqi; Aktoret dhe aktivistet: Melihate Qena, Dardana Mehmeti, Donikë Ahmeti, Arta Gashi, Albina Kelmendi dhe Bashkime Sulejmani.

Përballje poezish “Poezia ime Slam” nga Flutura Balaj; Koreografe: Fjolla Hana dhe Muzika: Lora Ajvazi.

Koncert nga PMS- Premenstrual Syndrome nga Shqipëria



DITA 2



DITA 3



Master klasë Class “Art i Grave në Lindjen e Mesme” me Lina Attel nga Jordani.

Panel diskutimi “Trupi im Zgjedhja ime” me panelistet: Vjollca Krasniqi, Visare Mujko-Nimani, Nita Luci dhe Leonidë Molliqaj; Moderatore: Mrika Aliu.

Pop In Talk me Venera Mustafa.

Shfaqje teatrore: “Ngjyrat e Gushtit” nga autorja Paloma Perero; Regjia: Ilire Vinca; Aktoret: Vjosa Maloku dhe Semira Laifi; Produksion i Fakultetit të Arteve dhe teatrit Oda.

Prezantimi i filmave të shkurtë, Fakulteti i Arteve në Prishtinë/ dega-Regjia e filmit: **“Kandër”** nga Trendelina Halili, **“Mona”** nga Lorena Sopi, **“Atilla”** nga Dina Morina, and **“Humbur në Shpresë”** nga Jehona Berisha.

Prezantimi i filmave të shkurtë, të huaj: “Ditëlindja” nga Daniela Lucato, **“Gjermania dhe Dhëmbët e Pjekurisë”** nga Sydney Lazarus, Kanadë.

Prezantimi i filmave dokumentarë të huaj: “Murgesha” nga Aida Schlaepfer / Irak dhe **“Kujtimet e nje klubi striptiz”** nga Silvana Lázaro Rosales, Meksikë.

DITA 4



Punëtorja “Shërimi i Plagës Amnore dhe Ndërlidhja me Aktivizmin”, Sandra Ljubinković nga Serbia

Panel diskutimi “Gratë dhe Prona” me panelistet: Luljeta Demolli, Sibel Halimi dhe Leonora Selmani; Moderatore: Teuta Hoxha.

Tre ekspozita: Ekspozitë dhe performancë “Revolta kundër Dhunës”, artistja Fitore Berisha / Islandë, e përcjellur me performancë me Agnes Nokshiqi dhe Tristan Halili; **Ekspozita: “Kur të vdes unë, bëni çfarë të doni”** nga Adela Jusiç; **Ekspozita: “Babi pse brengosesh”** nga Zymryte Hoxha.

Koncert Duo me Rina Kaçinari, violingello dhe vokal, dhe Jörg Mikula, baterist dhe vokal.

Punëtorja: “Ri/shikimi i Grave n’Dramë” me Doruntina Basha.

Film dokumentar “Më thirr Barbara” - Regjia: Ana Jakimska, përcjellur me një ligjeratë nga OJQ “CEL” për transgjjinorët.

Shfaqja teatrale “Qielli i Heshtur” me regji të Armela Demaj dhe aktorë/e: Jonida Beqo, Sonila Kapidani, Nigela Ruka, Redian Mulla dhe Verjana Abazaj.

Koncert “Larg Pa Lo Kor” të Christine Salem Harry Perigone, David Abrousse dhe Sebastien Martel



DITA 5



DITA 6



Punëtorja: “Identifikimi dhe pasojave i ngacmimeve seksuale” me Dua Dauti –Kadriu.

Punëtorja: “Aktivizimi i vajzave të reja” me Jelena Memet and Andrijana Kocič.

Panel diskutimi: “Burrat dhe Feminizmi” me panelistët: Agon Maliqi, Ilir Bajri, Artan Sadiku dhe Rron Gjinojci; Moderatore: Yllka Soba.

Promovimi i librit: “Valsi i mesnatës” nga Ilire Zajmi-Rugova, me interpretim të Anisa Ismailit, Melihate Qena, Shpëtim Selmani, Fitore Broqi and Qëndresa Kajtazi.

Shfaqje teatrale: “Rrëfimet Private”. Produksion i Studios Filmike të Shkupit në bashkëpunim me të Teatrit Kombëtar të Maqedonisë. Regji: Nina Nikolikj; Aktorë/e: Amernis Nokshiq Jovanovska, Nina Dean, Petre Arsovski, Oliver Mitkovski, Darja Rizova, Katina Ivanova, Blagoj Veselinov.

Koncert i DAM Festivalit me Besa Lluginiqi, soprano dhe Lirika Pula, piano.

Ndejë dhe muzikë me Egzona Ademi & Band.



FEMART FESTIVAL 5 – E PATREMBUR


25-31 maj 2017

Edicioni i 5-të i festivalit FemArt u mbajt gjatë periudhës 25-31 Maj, 2017 (7 ditë) në Prishtinë dhe Mitrovicë të Veriut.

Motoja e festivalit për këtë vit ishte I/E PATREMBUR, duke inkurajuar qëndrueshmëri dhe solidaritet me gratë dhe burrat të cilëve iu shkelen të drejtat në bazë të etnitetit, qëndrimit shoqëror, racës dhe preferencave seksuale.

Programi i festivalit përfshinte temat: të drejtat e njeriut, të drejtat e shëndetit seksual dhe riprodhues, paqja dhe drejtësia tranzicionale, të drejtat LGBTQI, fuqizimi i grave dhe vajzave, shkëmbimi i përvojave të suksesshme në rajon dhe në botë, dhuna në baza gjinore e shumë të tjera.

Gjatë këtyre shtatë ditëve festivalin e përshkuan mbi 100 artiste/artistë dhe aktiviste/aktivistë (gra dhe burra) nga vende të ndryshme që u përfshinë përmes aktiviteteve dhe projekteve të tyre, perderisa vullnetarët/et e komuniteteve që jetojnë në Kosovë, ishin pjesë e organizimit.



Kosova



Anglia



Belgjika



Bosna e
Hercegovina



Bullgaria



Franca



Italia



Izraeli



Jordania



Kroacia



Maqedonia
Veriore



Rumania



Serbia



SHBA



Shqipëria



Ukraina

Si çdo vit rreth 20 vullnetarë/e nga gruper dhe komunitetet e ndryshme u bënë pjesë e festivalit të cilët me punën dhe përvojën e fituar ngritën kapacitetet e tyre për menaxhimin kulturor.

Festivali i vizitua nga: **5,000** njerëz.

Edicioni i 5-të i festivalit FemArt u përkrah nga shumë donatorë: Projekti i fondeve të BE menaxhuar nga zyra e Bashkësisë Evropiane në Kosovë, Kvinna till Kvinna, UNFPA, Ministria e Integrimeve Evropiane, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, U.S Ambasada në Kosovë, UNWOMEN, Koalicioni K10, Komuna e Prishtinës, Ipko Fondacioni dhe Unë e Du Kosovën.

Sponsorët medial: KultPlus, KlanKosova, Radio dhe Televizioni i Kosovës – RTK, Telegrafi.com dhe Kosoalive 360.

Partnerët Insitutional: Teatri ODA, EU Information and Cultrual Center, Teatri Dodona, Monet Arts & Books Gallery, PEN dhe JCodors Academy.



Shfaqje e vallëzimit



Shfaqje
teatrore




Filma
artistik

Performancë
e rrugës



Takim me poetin

Filma
dokumentar



Koncerte
muzikore



Yoga dhe sesion meditives



Përballje
poetike

Komed Stand-Up



Ekspozita

Instalacion
artistik



Forum



Prezantime



Panele
